



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE

RAPORT MONITORIMI PËR ZBATIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2021

Në zbatim të nenit 65 të Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit tëbuxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore u krijua bazuar në ligjin nr. 111/2012, për “Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar, VKM-së nr.221, datë 26.4.2018 për “Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore” si dhe Urdhrit nr. 152, datë 1.10.2018 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, i ndryshuar me Urdhrin nr. 17, datë 30.01.2020 ku në përbërje të saj përveç zyrës qendrore të AMBU-së janë edhe katër Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore, respektivisht ZABU Drin Bunë me qendër në Shkodër, ZABU Vjosë me qendër në Vlorë, ZABU Shkumbin Seman me qendër në Fier dhe ZABU Ishëm Erzen Mat me qendër në Tiranë. Aktualisht AMBU-ja ushtron aktivitetin e saj buxhetor nëgrupin 87, në programin buxhetor “Administrimi i Ujërave”, me kod 05640.

Në përdorimin e fondeve buxhetore jemi mbështetur në parimet e menaxhimit dhe funksionimit të sistemit buxhetor. Shpërndarja e burimeve financiare është bërë në përputhje me objektivat e AMBU-së, duke pasur si synim një përdorim më eficient të këtyre burimeve financiare sipas programimit të bërë për vitin buxhetor 2021.

I. SHPENZIMET KORENTE

Fondet buxhetoretë miratuara për vitin 2021 për Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore në total janë 202,650,000 lekë, prej të cilave 97,400,000 lekë janë shpenzime korente, 105,000,000 lekë për shpenzime kapitale dhe 250,000 lekë janë parashikuar për transfertat për familjarë dhe individë. Në zbatim të VKM-së nr. 673, datë 02.09.2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publik”, me anë të shkresës me nr. prot. 318, datë 10.03.2021, me lëndë “Kërkesë për transferimin e fondeve buxhetore”, drejtuar MFE-së, u kërkua transferim fondesh përkatësisht; pakësim i llog. 602 (kod produkti 98708AA) me 88,000 dhe shtim i llog.606 (kod produkti 98708AA) me 88,000 lekë. Gjithashtu, në zbatim të Aktit Normativ nr. 26, datë 23.06.2021, është pakësuar llog.ekonomike 602, përkatësisht produkti 98708AA është pakësuar me 2,000,000 lekë; produkti 98708AB është pakësuar me 500,000 lekë; 98708AC është pakësuar me 500,000 lekë. Pas Aktit Normativ me nr. 34, date 03.12.2021, është pakësuar llogaria ekonomike 600, me 12,000,000 lekë dhe llog.ekonomike 601, me 2,000,000 lekë.

Këto fonde, sipas zërave të strukturës buxhetore, paraqiten sipas tabelës më mëposhtë, ku jepen edhe realizimet përkatëse për secilin prej tyre, për vitin 2021.


Tabela nr.1 Realizimi i shpenzimeve korente për vitin 2021

(në 000 lekë)

Entiteti i qeverisjes	Kodi i institucionit	Kapitulli	Programi	Llog. Ekonomike	Kod produkti	Buxheti vjetor	Buxheti rishikuar (Pas 2 AN)	Fakti	Diferenca	% e realizimit
AMBU	87	1	05640	600	98708AA	66,760	54,760	51,554	3,206	94
AMBU	87	1	05640	601	98708AA	11,720	9,720	8,727	993	90
AMBU	87	1	05640	606	98708AA	250	338	130	208	38
AMBU	87	1	05640	602	Total	18,920	15,832	8,070	7,762	51
AMBU	87	1	05640		98708AA	7,920	5,832	2,578	3,254	44
AMBU	87	1	05640		98708AB	5,000	4,500	2,894	1,606	64
AMBU	87	1	05640		98708AC	6,000	5,500	2,599	2,901	47
Totali						97,650	80,650	68,481	12,169	85

Ndërsa grafikisht, realizimi i treguesve sipas llogarive ekonomike për vitin 2021 jepet si më poshtë.

Grafiku nr.1 Realizimi i treguesve të shpenzimeve korente për vitin 2021



Referuar tabelës 1, realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korente VITIN 2021 është në masën 85%, në raport me fondet totale buxhetore (sipas buxhetit të rishikuar). Faktorët që kanë ndikuar në këtë vlerë realizimi janë të analizuar si më poshtë vijon:

Në artikullin 600 & 601 “Fondi i pagave dhe Sigurimeve shoqërore & shëndetësore” - fondet janë realizuar, respektivisht nga 94% dhe 90% e buxhetit vjetor të rishikuar.

Vlera e realizuar është për arsye të vendeve vakante të krijuara në institucion. Njëkohësisht, i njëjti argument vlen edhe për realizimin e artikullit 601, përfshirë këtu edhe raportet për barrë lindje të cilat paguhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore si dhe ato me paftësi të përkohëshme.

Në artikullin 602 “Shpenzime Operative” - janë realizuar në masën 51% në raport me totalin e buxhetit të rishikuar. Kjo vlerë vjen si pasojë e faktit të mos funksionimit me

kapacitet të plotë të institucionit për arsye të vendeve vakante. Njëkohësisht shumë aktivitete janë anuluar ose zhvilluar në platforma online si rrjedhim i situatës së pandemisë së Covid 19.

II. INVESTIMET


Tabela nr.2 Realizimi i investimeve për vitin 2021

(000 lekë)

Entiteti i qeverisjes	Kodi i institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi i projektit	Buxheti vjetor	Fakti	% e realizimit
Menaxhimi i Integruar i burimeve ujore (Projekti ADA & BE)	87	2	05640	231	18 AQ 001	93,000	87,897	95%
TVSH (Projekti ADA & BE)	87	4	05640	231	18 AQ 002	12,000	3,733	31%
Total						105,000	91,631	87%

Referuar informacionit të Tabelës nr. 2, realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale vitin 2021 është në masën 87% e fondit të alokuar. Projekti “Menaxhimi i Integruar i burimeve ujore (Projekti ADA & BE)” i cili është financim i huaj me kod 18AQ001 si dhe TVSH e tij me kod 18AQ002 është në vazhdim dhe janë realizuar respektivisht në masën 95% dhe 31% të vlerës totale.

Grafiku nr.2 Realizimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2021



III. Objektivat për vitin 2021

Objektivi kryesor i institucionit është: Sigurimi, mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i burimeve ujore

Realizimi i objektivave nënkupton realizimin e aktiviteteve dhe produkteve, të pasqyruara në PBA për vitin buxhetor 2021.

Në funksion të realizimit të objektivave janë kryer aktivitetet dhe realizuar produktet si më poshtë vijon:

Produkti A: Akte ligjore dhe nënligjore për menaxhimin e integruar të burimeve ujore – me kod 98708AA është realizuar në masën 89 % nga ana buxhetore (sipas buxhetit të rishikuar). Referuar VKM 1121. 30.12.2020 "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektaketeve që do të paraqiten për shqyrtim në KM gjatë vitit 2021" dhe VKM 90 date 17.2.2021 "Per miratimin e planit kombëtar për intergrimin evropian 2021-2023", nuk ka parashikuar akte për tu miratuar. Megjithatë gjatë vitit 2021 është ngritur grupi nderinstitucional i punës me urdhërin e KM, për hartimin e ligjit të ri të burimeve ujore dhe draft akteve nënligjore, dhe ka arritur të finalizojë konsultimin e draft Ligjit "Per Burimet Ujore" dhe draft ligjit "Per Strategjine Detare te Republikës se Shqipërisë". Gjithashtu nisur nga nevoja për disa ndryshime në VKM nr.2, date 6.01.2020, gjatë vitit 2021 është miratuar një projektakt i parashikuar, me VKM nr. 626, date 27.10.2021 "Per Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Suedisë, për forcimin e kapaciteteve të AMBU".

Produkti B: Sistemi i furnizimit me të dhëna i Kadastrës Kombëtare të Ujit i përmirësuar – me kod 98708AB është realizuar në masën 64 % të fondeve buxhetore (sipas buxhetit të rishikuar). Në këtë rast raportohet realizimi në lidhje me (a) furnizimin e Kadastrës me të dhënat që administrohen nga organet e menaxhimit të burimeve ujore (lejet/autorizimet, hartat e rrezikut nga permbytjet etj) si edhe (b) Masa e realizimit mbështetet në nivelin e realizimit të disa proceseve bashkërenduese e paraprake që i shërbyjnë popullimit të Kadastrës nga ente të tjera të ngarkuara me këtë përgjegjësi..

Produkti C: Zbatimi i politikave dhe i dokumentave strategjik dhe planifikues, me qëllim menaxhimin e integruar të burimeve ujore – me kodkod 98708AC është realizuar në masën 47% e fondeve buxhetore (sipas buxhetit të rishikuar). (a) Duke filluar nga 1.1.2021 aplikimi për pajisje me leje/autorizim për përdorim të burimeve ujore kryhet vetëm nëpërmjet sistemit elektronik. Kjo risi, pavarësisht asistencës së vazhdueshmë nga organet e menaxhimit të burimeve ujore, në fillimet e saj ka sjellë një vështirësi në mënyrën e aplikimit

dhe njohuritë që subjektet duhet të kenë për përdorimin e sistemit. Gjithsej aplikime të kryera nga subjektet dhe të trajtuara në total 318, ndërkohë të konsideruara të rregullta e të miratuara 52. Niveli i këtij tregusi varet nga saktësia e aplikuesve në dokumentet e aplikimit dhe afatet. (b) Duke filluar nga 1.1.2021 ka filluar zbatimin e planit të masave të planeve të menaxhimit të banceve Drin-Bunë dhe Seman dhe periudhën 2021 është zbatuar vetëm 10% e planit të masave të parashikuar për realizim.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

GERTA LUBONJA



Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve
Per vitin 2021

ne 000 leke

Ministria		Agjencia e Menaxhimit te Burimeve Ujore			Kodi	1087016	
Programi		Administrimi I Ujorave			Titulli	05640	
Artikulli		Totali Shpenzimeve					
Kodi	Kod produkti	(1) MTBP Plan 2021	(2) Buxheti 2021	(3) Buxheti i Rishikuar 2021	(4) Fakti viti 2021	(5)=(2)-(4) Diferenca	
600	98708AA	Paga	66.760	66.760	54.760	51.554	3.206
601	98708AA	Sigurime Shoqërore	11.720	11.720	9.720	8.727	993
602	98708AA	Mallra dhe Shërbime të Tjera	7.920	7.832	5.832	2.578	3.254
	98708AB	Mallra dhe Shërbime të Tjera	5.000	5.000	4.500	2.894	1.606
	98708AC	Mallra dhe Shërbime të Tjera	6.000	6.000	5.500	2.599	2.901
603		Subvencione					-
604		Transferta Korente të Brendshme					-
605		Transferta Korente të Huaja					-
606	98708AA	Trans per Buxh. Fam. & Individ	250	338	338	130	208
Nen-Totali		Shpenzime Korrente	97.650	97.650	80.650	68.481	12.169
230		Kapitale të Patrupëzuara					
231		Kapitale të Trupëzuara	105.000	105.000	105.000	91.631	13.369
	18AQ001	Projekti BE - ADA	93.000	93.000	93.000	87.897	5.103
	18AQ002	TVSH per projektin BE - ADA	12.000	12.000	12.000	3.733	8.267
Nen -Totali		Shpenzime Kapitale	105.000	105.000	105.000	91.631	13.369
Totali		Korrente dhe Kapitale	202.650	202.650	185.650	160.112	25.538

Shpenzime Korrente	
Shpenzime Kapitale	
Gjithsej	

Ne %	Ne %
85	85
87	87
86	86



Drejtesuesi i EMP	Emri	<i>[Signature]</i>	Titullari Institucionit	Emri	
	Firma			Firma	
	Data	<i>17.1.2022</i>		Data	

**Formati nr.7 : Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve
Per vitin 2021**

ne 000 leke

Agjencia e Menaxhimit te Burimeve Ujore		Shpenzimet e Ministrisë				Kodi i Grupit	87
Programet		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)=(2)-(4)	
Titulli	Emri i Programit	PBA Plan 2021	Buxheti 2021	Buxheti i Rishikuar 2021	Fakti 2021	Diferenca 2021	
05640	Administrimi I ujërave	202.650	202.650	185.650	160.112	25.538	
Totali Institucioni Buxhetor		202.650	202.650	185.650	160.112	25.538	

Drejtuesi i EMP	Emri	<i>Alban Seleni</i>	Titullari Institucionit	Emri	<i>Gerta Lubonja</i>
	Firma	<i>[Signature]</i>		Firma	<i>[Signature]</i>
	Data	<i>17.1.2022</i>		Data	




Formati Nr. 8 : Raporti i Realizimit te Produkteve te Programit Për vitin 2021

Ministria	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore	Kodi		1087016
-----------	---	------	--	---------

Programi	Administimi I Ujërave	Titulli		05640
----------	-----------------------	---------	--	-------

Kodi i Produktit	Emri i Produktit	Njësia Matëse	Sasia e planifikuar per vitin 2021	Sasia e realizuar deri sot	Analiza e Realizimit			Komente
					Plotësisht	Pjesërisht	Aspak	
98708AA	Akte ligjore dhe nënligjore për menaxhimin e integruar të burimeve ujore	Numer aktesh	8	0				Referuar VKM 1121. 30.12.2020 "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektaketeve që do të paraqiten për shqyrtim në KM gjate vitit 2021" dhe VKM 90 date 17.2.2021 "Per miratimin e planit kombetar per intergrimin evropian 2021-2023", nuk ka parashikuar akte per tu miratuar. Megjithate gjate vitit 2021 eshte ngritur grupi nderinstitucional i punes me urdherin e KM, per hartimin e ligjit te ri te burimeve ujore dhe draft akteve nenligjore, dhe ka arritur te finalizojë konsultimin e draft Ligjit "Per Burimet Ujore" dhe draft ligjit "Per Strategjine Detare te Republikes se Shqiperise". Gjithashtu nisur nga nevoja për disa ndryshime ne VKM nr.2, date 6.01.2020, gjatë vitit 2021 është miratuar nje projektakti i paparashikuar, me VKM nr. 626, date 27.10.2021 "Per Miratimin e marrevshjes ndryshuese të marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Suedisë, për forcimin e kapaciteteve të AMBU".
98708AB	Sistemi i furnizimit me të dhëna i Kadastrës Kombëtare të Ujit i përmirësuar	% e të dhënave	100%	(a) 100% të dhënat e organeve të menaxhimit të burimeve ujore / (b) 5%		(a) Plotësisht / (b) Pjesërisht		Në këtë rast raportohet realizimi në lidhje me (a) furnizimin e Kadastrës me të dhënat që administrohen nga organet e menaxhimit të burimeve ujore (lejet/atorizimet, hartat e rrezikut nga permbytjet etj) si edhe (b) Masa e realizimit mbështetet në nivelin e relazimit të disa proceseve bashkërenduese e paraprake që i shërbjnë popullimit të Kadastrës nga enetë të tjera të ngarkuara me këtë përgjegjësi.
98708AC	Zbatimi i politikave dhe i dokumentave strategjik dhe planifikues, me qëllim menaxhimin e integruar të burimeve ujore	Nr leje/autorizime	360 leje	52 nga 360 (14.4 %)		Pjesërisht		(a) Duke nntuar nga 1.1.2021 aplikimi per pajisje me leje/autorizim per perdorim të burimeve ujore kryhet vetem nëpërmjet sistemit elektronik. Kjo risi, pavarësisht asistencës së vazhdueshmë nga organet e menaxhimit të burimeve ujore, në fillimet e saj ka sjellë një vështirësi në mënyrën e aplikimit dhe njohuritë që subjektet duhet të kenë për përdorimin e sistemit. Gjithësej aplikime të kryera nga subjektet dhe të trajtuara në total 318, nderkohë të kosideruara të rregullta e të miratuara 52. Niveli i këtij tregusi varet nga saktësia e aplikuesve në dokumentet e aplikimit dhe afatet / (b) Duke filluar nga 1.1.2021 ka filluar zbatimin e planit të masave të planeve të menaxhimit të banskeneve Drin-Bunë dhe Seman dhe per tu dhen 2021 është zbatuar vetëm 10%

Drejtuesi	Emri	<i>Elbana Tolsoni</i>	Titullari Institucionit	Emri	Gerta Labonia
	Firma	<i>[Signature]</i>		Firma	
	Data	<i>17.1.2022</i>		Data	



**Formati nr.9 : Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Produkteve
Per vitin 2021**

ne 000 leke

Agjencia e Menaxhimit te Burimeve Ujore					Kodi	87
Programi	Administrimi I Ujërave				Titulli	05640
Kodi i	Emri i Produktit	PBA Plan 2021	(1)		Mbetja (1-2)	% Realizimit
			Buxheti 2021 rishikuar 2021	Fakti Janar- Dhjetor 2021		
98708AA	Akte ligjore dhe nënligjore për menaxhimin e integruar të burimeve ujore	86.650	70.650	62.989	7.661	89
98708AB	Sistemi i furnizimit me të dhëna i Kadastrës Kombëtare të Ujit i përmirësuar	5.000	4.500	2.894	1.606	64
98708AC	Zbatimi i politikave dhe i dokumentave strategjik dhe planifikues, me qellim menaxhimin e integruar të burimeve ujore	6.000	5.500	2.599	2.901	47
		97.650	80.650	68.481	12.169	85

Drejtuesi	Emri	Albania Seluskeri	Titullari Institucionit	Gerta Lubonja
	Firma			
	Data	Jan 17-1-2022		



Formati nr.10 : FORMULARI I MONITORIMIT TE INVESTIMEVE

Per vitin 2021

Në 000 lekë

	<i>Emertimi i Projektit</i>	<i>Kodi I Projektit</i>	<i>Buxheti 2021</i>	<i>Fakti</i>	<i>Realizimi ne %</i>	<i>Komente (Problematika)</i>
	TOTALI		105.000		-	
1	Menaxhimi i Integruar i burimeve ujore (Projekti ADA & BE)	18AQ001	93.000	87.897	95	
2	TVSH (Projekti ADA & BE)	18AQ002	12.000	3.733	31	

Drejtuesi i EMP	Emri	<i>Ilbana Telen</i>	Titullari I Institucionit	Emri	Gerta Lubonja
	Firma	<i>[Signature]</i>		Firma	
	Data	<i>17-1-2022</i>		Data	

